

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

DREJTORIA E POLITIKËS MONETARE DHE E HULUMTIMIT



Treguesit më të rinj makroekonomikë
Rishikim i gjendjes aktuale

Tetor, 2022

Treguesit më të rinj makroekonomikë

Rishikimi i gjendjes aktuale – ndikimi ndaj politikës monetare

Rishikimi i gjendjes aktuale synon të japë një pasqyrë të të dhënave më të fundit makroekonomike (korrik – shtator 2022) dhe një krahasim me projeksionet më të fundit makroekonomike (prill 2021). Kjo do të vërtetojë se si gjendja aktuale e ekonomisë korrespondon me lëvizjet e pritshme të variablave në ciklin e fundit të projeksioneve. Rishikimi është përqendruar në ndryshimet e supozimeve dhe të realizimeve të jashtme në variablat e brendshme dhe si janë pasqyruar këto ndryshime në mjedisin e drejtimit të politikës monetare.

Vlerësimet e fundit për rritjen e ardhshme të ekonomisë globale janë më pak të favorshme, veçanërisht për vitin 2023¹, si pasqyrim të konfliktit të zgjatur ushtarak në Ukrainë dhe të krizës energjetike në Eurozonë, politikave monetare kufizuese, reduktimit të besimit dhe fuqisë blerëse të popullsisë. **Në të njëjtën kohë, rreziqet që rrethojnë projeksionet për rritjen globale janë në rënie** dhe lidhen kryesisht me efektet negative ndoshta më të forta të furnizimeve të reduktuara të energjisë nga Rusia në Europë, si dhe me çmimet ndoshta më të larta të karburanteve dhe ushqimeve, borxhin e lartë të vendeve me rritje të shpejtë dhe rritjen më të dobët të Kinës. Në raport me **Eurozonën**, si partneri ynë kryesor tregtar, treguesit nga anketat hulumtuese të subjekteve ekonomike në shtator tregojnë një ngadalësim të ndjeshëm të rritjes vjetore të aktivitetit ekonomik në tremujorin e tretë. Nga ana tjetër, lëvizjet e tregut të punës vazhdojnë të jenë të favorshme, me shkallën mesatare të papunësisë në muajt korrik - gusht në nivelin më të ulët historik prej 6,6%². Inflacioni në Eurozonë në shtator arriti për herë të parë një shkallë dyshifrore prej 10% me bazë vjetore (9,1% në gusht), me një rritje të fortë të çmimeve të të gjithë komponentëve. Kështu, pritshmëritë e tregut shoqërohen me vazhdimin e politikës monetare kufizuese nga BQE-ja në periudhën e ardhshme, kështu që vlerësimet më të fundit për **normën e huaj të interesit EURIBOR** me afat maturimi njëmuajor janë rishikuar në rritje, veçanërisht për vitin 2023.

Nga këndvështrimi i treguesve të veçantë sasiorë për mjedisin e jashtëm, që janë të rëndësishme për ekonominë maqedonase, vlerësimet për vitin 2022 dhe 2023 për kërkesën e huaj efektive janë rishikuar në rënie, krahasuar me parashikimet e prillit, veçanërisht për vitin 2023, ndërsa në inflacionin efektiv të huaj janë rishikuar në kahe në rritje. Në aspekt të kursit valutor EURO/USD, dollari amerikan pritet të vlerësohet ndjeshëm më shumë në vitin 2022 dhe të vlerësohet lehtësisht në vend të zhvlerësimit në vitin 2023, krahasuar me vlerësimet e prillit. Pritshmëritë e çmimeve botërore të mallrave, të shprehura në euro, janë rishikuar kryesisht në rënie për vitin 2022 dhe 2023 krahasuar me projektimet e prillit. Lëvizjet dhe vlerësimet e çmimeve të produkteve parësore vazhdojnë të jenë jashtëzakonisht të paqëndrueshme dhe nën ndikimin e fuqishëm të zhvillimeve në lidhje me konfliktin ushtarak ruso-ukrainas, që krijon pasiguri të madhe për dinamikën e ardhshme të tyre dhe efektet në ekonominë globale dhe vendase, veçanërisht në afat të shkurtër.

Treguesit më të fundit të ekonomisë vendase flasin për një pasqyrë makroekonomike që është më së shumti në përputhje me projeksionet e prillit, por ka devijime në disa segmente, kryesisht nën ndikimin e ndryshimeve në mjedisin e jashtëm. Sipas të dhënave të vlerësuara të publikuara nga EShS-ja, në tremujorin e dytë të vitit 2022 PBB-ja realizoi një rritje reale prej 2,8% në bazë vjetore (2,4% në tremujorin paraardhës), që paraqet rritje të mëtijshme të ekonomisë vendase, në përputhje me projeksionin për këtë tremujor gjatë ciklit të prillit. Të dhënat e frekuencës së lartë për periudhën korrik - gusht 2022 tregojnë kryesisht një ngadalësim të rritjes së aktivitetit ekonomik në tremujorin e tretë të vitit, nën ndikimin e efekteve të pafavorshme të luftës në Ukrainë mbi çmimet dhe furnizimin, si dhe gjatë ndryshueshmërisë dhe

¹ Sipas raportit të Perspektivës Ekonomike të OECD-së, shtator 2022.

² I referohet periudhës nga prilli 1998, kur publikohen të dhënat mujore për shkallën e papunësisë në Eurozonë.

pasigurisë së theksuar të kushteve të jashtme ekonomike dhe financiare. Kështu, në këtë periudhë vihet re një ngadalësim i ndjeshëm i rritjes reale vjetore të qarkullimit në totalin tregtar, ndryshimi vjetor i prodhimit industrial ka hyrë në zonën negative dhe aktiviteti në ndërtim shënon lëvizje të mëtejshme negative. **Sa u përket ndryshimeve në çmimet e konsumit, shkalla vjetore e inflacionit në tremujorin e tretë të vitit 2022 është 17,2% dhe është më e lartë se projeksionet e fundit.** Inflacioni vazhdon të burojë nga faktorët e anës të ofertës, pra nga rritja e çmimeve të importit të ushqimeve dhe energjisë, përfshirë çmimin vendas të energjisë elektrike dhe të ngrohjes, të cilët janë ndikuar nga zhvillimet në tregun botëror të energjisë. Rritja e tyre afatgjatë dhe më e fortë krijon efekte transferimi në çmimet e produkteve dhe shërbimeve të tjera. Rishikimet në lidhje me lëvizjet e pritshme në supozimet hyrëse të jashtme për projeksionin e inflacionit janë kryesisht në kahe në rritje, që së bashku me realizimet më të larta të inflacionit krijon rreziqe në rritje në raport me shkallët e parashikuara të inflacionit për këtë vit. Në kushtet e luhatjeve të theksuara në lëvizjen e çmimeve botërore të produkteve primare, të shkaktuara kryesisht nga lufta në Ukrainë dhe sanksionet ndaj Rusisë, lëvizja e tyre është e ndryshueshme dhe e vështirë për t'u parashikuar, kështu që pasiguria në lidhje me lëvizjet e çmimeve në të ardhmen mbetet jashtëzakonisht e theksuar.

Analiza e treguesve të mjaftueshmërisë së rezervave valutore tregon që vazhdojnë të jenë në zonën e sigurt dhe rritja e tyre në tremujorin e tretë është mbi nivelin e projektuar. Të dhënat në dispozicion për sektorin e jashtëm tregojnë një deficit tregtar në periudhën korrik – gusht më të lartë se sa pritej për tremujorin e tretë të vitit. Të dhënat për operacionet e këmbimit në shtator të vitit 2022 tregojnë hyrje neto më të larta nga transferet private se sa pritej për tremujorin e tretë të 2022, sipas projeksionit të prillit.

Sa u përket **zhvillimeve në sektorin monetar**, totali i **depozitave** në gusht u rrit për 1,2% me bazë mujore. Rritja vjen më së shumti nga rritja e depozitave të ndërmarrjeve, me një kontribut më të vogël pozitiv të depozitave të amvisërive dhe sektorëve të tjerë. Nga pikëpamja valutore vihet re një rritje e depozitave në valutë (përfshirë paratë e depozitave), me një kontribut të vogël negativ të depozitave në valutë. Në bazë vjetore, gjithsej depozitat në gusht të vitit 2022 janë më të larta për 1,4%, me një rritje vjetore të projektuar prej 4,7% për tremujorin e tretë. **Totali i kredive** të sektorit privat shënoi rënie të lehtë mujore prej 0,3% në gusht. Kreditë e ndërmarrjeve kontribuojnë në rënien mujore të gjithsej kredive, ndërsa kreditë e amvisërive kanë një kontribut të vogël pozitiv. Sipas strukturës valutore, kreditë në valutë vendase janë në rënie, ndërsa kreditë në valutë janë në rritje mesatare. Në bazë vjetore, rritja e gjithsej kredive në gusht ishte 9,7%, ndërsa rritja e projektuar për tremujorin e tretë të vitit 2022 ishte 8,8%, në përputhje me projeksionin e prillit.

Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën janar - gusht 2022 është realizuar deficit prej 11.130 milionë denarë. Deficiti buxhetor financohet më së shumti duke përdorur depozitat e shtetit në Bankën Popullore dhe në një masë më të vogël nga huamarrja e shtetit në tregun vendas të letrave me vlerë. Deficiti buxhetor i realizuar për periudhën janar-gusht 2022 përfaqëson 26% të deficitit të parashikuar me rebalancin e buxhetit të vitit 2022.

Treguesit e fundit makroekonomikë vazhdojnë të tregojnë për realizimin e rreziqeve në segmente të caktuara të ekonomisë, që krijon një mjedis makroekonomik më pak të favorshëm për zbatimin e politikës monetare. Rritja e çmimeve vendase vazhdon edhe në shtator dhe është mbi projektimin, dhe lëvizjet kanë ardhur ekskluzivisht nga komponenti ushqimor dhe energjetik. Çmimet e importit, mbi të gjitha të energjisë dhe ushqimeve, vazhdojnë të rriten më fort se sa pritej dhe më së shumti kontribuojnë në inflacionin vendas, por edhe ndikojnë në pritshmëritë inflacioniste. Edhe pse vazhdojnë rishikimet në rënie të pritshmërive të rritjes për një pjesë të çmimeve të ushqimeve, rishikimet për rritjen e ardhshme të çmimeve të importeve janë kryesisht në rritje, që së bashku me realizimet më të larta inflacioniste krijon rreziqe në rritje në raport me shkallën e parashikuar të inflacionit. Natyrisht, pasiguria e dinamikës së ardhshme të çmimeve të produkteve primare në bursa vazhdon të jetë e theksuar për shkak të zhvillimeve ushtarake në Ukrainë. Sa i përket rritjes ekonomike, realizimet në tremujorin e dytë të vitit 2022 janë në linjë me ato të parashikuara. Megjithatë, të dhënat në dispozicion me frekuencë të lartë për aktivitetin vendas

ekonomik në tremujorin e tretë janë të pafavorshme dhe tregojnë një ngadalësim të rritjes, në përputhje me rishikimet e vazhdueshme në rënie të kërkesës së huaj për shkak të efekteve të konfliktit ushtarak në Ukrainë dhe të krizës së zgjeruar energjetike. Rezervat valutore vazhdojnë të jenë në nivele të përshtatshme dhe në zonën e sigurt, me lëvizje të favorshme në tregun valutor në tremujorin e tretë dhe me një fluks të konsiderueshëm valutor në tregun valutor. Në sektorin monetar, aktiviteti kreditor vazhdon të jetë solid dhe mbi parashikimet, kurse dinamika e rritjes së totalit të depozitave është më mesatare në krahasim me pritshmëritë.

Shuma neto e blerë në valutë në tregun valutor është në rritje

Analiza e ndryshimeve në pozicionin e bilancit në vitin 2022 tregon rimëkëmbjen e ndjeshme të tregut valutor, pas rënies së theksuar në vitin 2020, për shkak të masave për parandalimin e përhapjes së Kovid-19 dhe lëvizjes së kufizuar të popullsisë. Rimëkëmbja graduale e aktivitetit ekonomik, si dhe heqja e kufizimeve në lëvizjen ndërkombëtare, kanë efekt pozitiv në tregun valutor, duke rritur potencialin valutor të vendit. Konkretisht, blerja neto në tregun valutor në periudhën janar - shtator 2022 është 1.214,3 milionë euro, që është për 319 milionë euro më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, me një rritje të lartë të ofertës prej rreth 402 milionë euro dhe një rritje më mesatare të kërkesës prej rreth 83 milionë euro. Lëvizjet më të theksuara në tregun valutor janë shënuar në tremujorin e tretë të vitit, ku është arritur blerja neto më e lartë historike e valutës në vlerë prej 559 milionë euro ose një rritje vjetore prej 147 milionë euro. Krahas dinamikës sezonale që është karakteristike për tremujorin e tretë të vitit, për zhvendosjet në rritje në transferet e parave të gatshme kontribuojnë edhe rritjet e ndjeshme të udhëtimeve drejt vendit tonë, si nga diaspora ashtu edhe nga turistët, por në një pjesë edhe hyrjet nga kursimet valutore të popullsisë që mbahen në para të gatshme dhe që përdoren për financimin e konsumit personal.

Селектирани макроекономски показатели ¹	2019								2020								2021												2022																	
	2016	2017	2018	Кв.1	Кв.2	Кв.3	Кв.4	2019	Кв.1	Кв.2	Кв.3	Кв.4	2020	јан.	фев.	март	Кв.1	апр.	мај	јун.	Кв.2	јул.	авг.	сеп.	Кв.3	окт.	ное.	дек.	Кв.4	2021	јан.	фев.	мар.	Кв.1	апр.	мај	јуни	Кв.2	јул.	авг.	септ.	Кв.3				
I. Реален сектор индикатори																																														
Бруто домашен производ (годишна реален раст) ^{1/2}	2,8	1,1	2,9	2,8	6,1	4,3	2,5	3,9	-1,3	-16,4	-5,9	-0,8	-4,7				-1,8				13,4								2,3	3,9																
Индустриско производство ^{1/3}																																														
стапка на промена (годишна)	3,4	0,2	5,4	8,8	1,1	7,1	1,3	3,7	-3,7	-25,0	-7,5	-2,3	-9,5	-13,5	-12,2	7,6	-6,1	46,1	16,5	9,5	22,2	-0,6	-1,4	-8,0	-3,5	-6,5	4,7	-4,9	-2,3	1,4	0,7	6,3	3,2	3,5	-3,8	8,6	-0,2	1,3	-5,0	0,2						
кумулятивна просечна стапка	3,4	0,2	5,4	8,8	4,8	5,6	3,7	3,7	-3,7	-14,6	-12,1	-9,5	-9,5	-13,5	-12,8	-6,1	-6,1	3,7	6,0	6,6	6,6	5,4	4,5	2,9	2,9	1,8	2,1	1,4	1,4	1,4	0,7	3,6	3,5	3,5	1,6	2,9	2,4	2,4	1,2	1,1						
Инфлација ^{1/4}																																														
ЦПИ Инфлација (годишна) ^{1/5}	-0,2	2,4	0,9	1,2	1,2	0,6	0,0	0,4	0,6	0,5	1,5	2,2	2,3	1,9	1,9	2,1	2,0	2,7	3,0	2,7	2,8	3,4	3,6	3,7	3,5	4,1	4,8	4,9	4,6	4,9	6,7	7,6	8,8	7,7	10,5	11,9	14,5	12,3	16,0	16,8	18,7	17,2				
ЦПИ Инфлација (кумулятивна просечна)	-0,2	1,4	1,5	1,2	1,2	1,0	0,8	0,8	0,6	0,5	0,9	1,2	1,2	1,9	1,9	2,0	2,0	2,2	2,3	2,4	2,4	2,5	2,7	2,8	2,8	2,9	3,1	3,2	3,2	3,2	6,7	7,1	7,7	7,7	8,4	9,1	10,0	10,0	10,9	11,6	12,4	12,4				
Базична инфлација (кумулятивна просечна)	1,3	2,3	1,5	0,9	0,9	0,8	0,5	0,5	0,7	0,6	0,7	0,9	0,9	1,8	1,7	1,6	1,6	1,6	1,7	1,8	1,8	2,0	2,1	2,2	2,2	2,2	2,3	2,4	2,4	2,4	3,2	3,7	4,2	4,2	4,7	5,1	5,4	5,4	5,6	5,9	6,2	6,2				
Базична инфлација (годишна) ^{1/5}	1,0	2,8	1,4	0,9	1,0	0,6	-0,4	-0,3	0,7	0,5	0,8	1,6	1,9	1,8	1,6	1,5	1,6	1,7	1,8	2,4	2,0	3,0	2,8	2,9	2,9	2,9	2,9	3,1	2,9	3,0	2,9	3,2	4,3	5,2	4,2	6,0	6,6	6,9	6,5	6,9	8,0	8,8	7,9			
Работна сила																																														
Стапка на невработеност	23,7	22,4	20,7	17,8	17,5	17,1	16,6	17,3	16,2	16,7	16,5	16,1	16,4				16,0				15,9				15,7				15,2	15,7																
II. Фискален сектор индикатори (Централен Буџет и Буџети на фондови)																																														
Вкупни буџетски приходи	169.356	179.673	188.505	46.042	50.076	50.986	56.718	203.822	46.484	40.923	48.585	53.562	189.554	14.806	16.423	17.667	48.896	19.271	15.726	17.410	52.407	20.190	17.132	19.151	56.473	20.055	19.133	21.057	60.245	218.021	16.767	18.852	21.549	57.168	21.777	16.895	20.587	59.259	21.230	19.317						
Вкупни буџетски расходи	185.407	196.561	200.071	49.243	53.915	52.085	62.202	217.445	53.895	59.458	58.511	71.557	243.421	18.995	19.176	19.101	57.272	19.242	20.759	21.206	61.207	22.338	22.489	19.538	65.365	18.739	24.299	29.924	73.062	256.906	20.226	22.248	21.363	63.837	19.785	20.653	22.498	62.936	21.057	20.274						
Вкупно салдо (векстосна основа)	-16.051	-16.888	-11.566	-3.201	-3.839	-1.099	-5.484	-13.623	-7.411	-8.535	-9.926	-17.995	-53.867	-4.189	-2.753	-1.434	-8.376	29	-5.033	-3.796	-8.800	-1.148	-5.357	-387	-8.892	1.316	-5.266	-8.867	-12.817	-38.885	-3.459	-3.396	186	-6.669	1.992	-3.758	-1.911	-3.677	173	-957						
Буџетско салдо (% од БДП) ^{1/6}	-2,7	-2,7	-1,8	-0,5	-0,6	-0,2	-0,8	-2,0	-1,1	-2,8	-1,5	-2,7	-8,0	-0,6	-0,4	-0,2	-1,2	0,0	-0,7	-0,5	-1,2	-0,4	-0,7	-0,1	-1,2	0,2	-0,7	-1,2	-1,8	-5,4	-0,4	-0,4	0,0	-0,8	0,2	-0,5	-0,2	-0,4	0,0	-0,1						
III. Финансови индикатори ^{1/8}																																														
Парична маса (М4), годишна стапка на раст	6,2	5,1	11,8	11,7	10,5	10,8	9,3	9,3	8,9	9,8	6,9	6,9	6,9	7,7	8,2	7,9	7,9	7,1	7,0	6,7	6,7	7,1	9,6	8,2	8,2	7,8	7,6	7,0	7,0	7,0	6,5	5,3	2,8	2,8	3,0	1,8	1,4	1,4	1,9	1,3						
Вкупни кредити, годишна стапка на раст	-0,1	5,4	7,3	9,0	8,1	5,6	6,0	6,0	5,8	6,6	7,3	4,7	4,7	4,6	4,4	5,2	5,2	5,7	5,6	5,1	5,1	5,2	6,4	6,3	6,3	6,7	7,7	8,3	8,3	8,3	8,3	8,4	8,9	9,8	9,8	10,0	9,9	10,0	10,0	9,7	9,7					
Вкупни кредити на население	7,0	9,2	10,3	9,7	9,9	9,5	10,5	10,5	10,1	8,8	9,5	8,0	8,0	7,4	7,1	8,1	8,1	8,9	8,8	8,7	8,7	8,0	7,9	7,5	7,5	7,3	7,7	7,8	7,8	7,8	7,8	7,8	7,8	7,9	7,9	7,8	8,0	7,7	7,7	7,6	7,7					
Вкупни кредити на претпријатија	-5,3	2,3	4,5	8,2	6,4	1,7	1,9	1,9	1,8	4,6	5,2	1,1	1,1	1,6	1,4	2,1	2,1	2,3	2,1	1,2	1,2	2,0	4,5	4,8	4,8	4,8	5,6	7,4	8,7	8,7	8,7	9,0	10,0	11,9	11,9	12,3	11,9	12,4	12,4	12,1	11,9					
Вкупни депозити (со депозити пари), годишна стапка на раст ^{1/7}	6,1	5,0	12,1	11,9	10,6	11,0	9,0	9,0	7,9	8,4	5,4	5,7	5,7	6,1	6,9	7,3	7,3	6,8	7,1	6,7	6,7	6,8	9,9	8,2	8,2	7,9	7,9	7,5	7,5	7,5	7,2	5,8	3,2	3,2	3,4	2,1	1,5	1,5	2,0	1,4						
Вкупни депозити на население	2,5	6,1	9,5	8,7	9,0	9,3	7,9	7,9	8,6	8,7	6,1	4,6	4,6	4,7	5,2	5,2	5,2	4,7	4,8	4,2	4,2	4,3	7,4	6,9	6,9	7,2	7,1	7,1	7,1	7,1	6,8	6,0	3,9	3,9	4,6	4,5	5,2	5,2	5,2	4,6						
Вкупни депозити на претпријатија	13,4	2,1	9,5	12,1	10,1	11,1	14,6	14,6	12,5	11,2	8,0	10,1	10,1	12,0	13,7	12,9	12,9	14,3	16,0	16,7	16,7	17,1	20,2	15,6	15,6	13,9	13,7	11,6	11,6	11,6	11,5	8,3	3,9	3,9	1,7	-1,6	-4,8	-4,8	-2,9	-3,8						
Каматни стапки ^{1/8}																																														
Каматна стапка на БЗ (крај на месец/квартал/година)	3,75	3,25	2,50	2,25	2,25	2,25	2,25	2,25	1,75	1,50	1,50	1,50	1,50	1,50	1,50	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,50	1,75	2,00	2,00	2,50	2,50	3,00	3,00						
Активни каматни стапки																																														
денарски	7,0	6,6	6,1	5,8	5,7	5,6	5,4	5,6	5,3	5,3	5,1	5,1	5,2	5,0	5,0	5,0	5,0	5,0	4,9	4,9	4,9	4,8	4,8	4,8	4,8	4,8	4,7	4,7	4,7	4,7	4,9	4,6	4,6	4,6	4,6	4,6	4,6	4,6	4,7							
девизни (агрегатна, за девизни и денарски со девизна клаузула)	5,7	5,3	4,9	4,7	4,7	4,6	4,5	4,6	4,4	4,3	4,3	4,2	4,3	4,2	4,2	4,1	4,2	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,0	4,0	4,0	4,0	3,9	3,9	3,9	4,0	4,0						
Пасивни каматни стапки																																														
денарски	2,5	2,2	2,0	1,9	1,9	1,9	1,7	1,9	1,6	1,5	1,4	1,4	1,5	1,3	1,3	1,3	1,3	1,3	1,2	1,2	1,2	1,1	1,1	1,1	1,1	1,1	1,1	1,1	1,1	1,2	1,0	1,0	1,0	1,0	1,0	1,0	1,0	1,0	1,0	1,0						
девизни (агрегатна, за девизни и денарски со девизна клаузула)	1,0	0,9	0,8	0,8	0,8	0,8	0,8	0,8	0,7	0,6	0,6	0,6	0,6	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,4	0,4														


Странска ефективна побарувачка
(годишни промени во %)



Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

Në vlerësimet më të fundit për **kërkesën e huaj efektive**, është bërë një rishikim në rënie i vlerësimeve për të gjithë periudhën e projeksioneve dhe veçanërisht për vitin 2023. Tani pritet që rritja të arrijë në 2,4% në vitin 2022 dhe 0,3% më 2023, kundrejt 2,9% dhe 2,8% në mënyrë përkatëse në prill. Korrigjime të tilla janë kryesisht për shkak të pritshmërive për uljen e aktivitetit ekonomik në Gjermani, veçanërisht në vitin 2023³.


Странска ефективна инфлација
(годишни стапки во %)



Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

Nga ana tjetër, vlerësimet e **inflacionit të huaj** janë rishikuar në rritje, me një rritje prej 9,1% dhe 6% në mënyrë përkatëse më 2022 dhe 2023, (5,7% dhe 3,2%, në mënyrë përkatëse në prill). Rishikimet janë për shkak të pritshmërive për inflacion më të lartë nga të gjithë partnerët tanë të importit, ku kontributin më të madh mesatarisht për dy vitet e fundit e kanë dhënë Gjermania dhe vendet e rajonit (Serbia, Kroacia dhe Sllovenia).

Курс евро/САД-долар



Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

Sa i përket **kursit valutor euro/dollar amerikan**, vlerësimet e fundit tregojnë për një vlerësim dukshëm më të lartë të dollarit amerikan ndaj euros në vitin 2022 dhe një vlerësim të vogël, në vend të zhvlerësimit të vogël të pritshëm në vitin 2023 sipas projeksioneve të prillit. Ndryshime të këtilla janë kryesisht një pasqyrim i shqetësimeve të investuesve për një recesion në Eurozonë për shkak të krizës energjetike, politikës monetare më kufizuese në SHBA në krahasim me BQE-në, si dhe rritjen e kërkesës për dollarin amerikan mes rreziqeve të rritura globale.

³ Rritja e projektuar e Gjermanisë prej 1,6% më 2022 dhe një rënie prej 0,5% më 2023, kundrejt rritjes prej 2,5% dhe 2,6%, në mënyrë përkatëse në prill më 2022 dhe 2023.

Нафта „брент“

(квартален просек, евра/барел)




Извор: ММФ, Светска банка и пресметки на НБРСМ.

Në **çmimin e naftës⁴ të shprehur në euro**, pritshmëritë për një forcim të ndjeshëm të vlerës së dollarit amerikan kundrejt euros kontribuojnë në rishikime në rritje (rritje më të lartë) në vitin 2022, në kushtet e perspektivës për uljen e kërkesës për shkak të rritjes së rreziqeve të një recesioni global. Nga ana tjetër, për vitin 2023 pritet rënie më e madhe e çmimit të naftës krahasuar me atë të projektuar në prill.

Цени на никелот и бакарот во евра

(годишни промени во %)



Извор: ММФ, Светска банка и пресметки на НБРСМ.

Sa u përket **çmimeve të metaleve**, rishikimet janë në rënie, me çmimet e bakrit dhe nikelit që pritet të shënojnë rritje dukshëm më të ulët në vitin 2022 në krahasim me vlerësimet e prillit, si dhe një rënie në vend të rritjes minimale të nikelit, por një rënie më të madhe me çmimin e bakrit më 2023. Lëvizjet e këtilla në bakër janë rezultat i shqetësimeve për uljen e kërkesës dhe rritjen e niveleve të inventarit, ndërsa te nikelit, korrigjimi në rënie është kryesisht për shkak të rritjes së ofertës së nikelit (rritje e prodhimit në Indonezi).

⁴ Për analizën e çmimeve të naftës, metaleve dhe produkteve ushqimore primare, përdoren raporte të ndryshme të FMN-së, Bankës Botërore, FAO-së, OPEK-ut, BQE-së dhe portaleve të specializuara ekonomike ndërkombëtare.


Цени на пченицата и пченката во евра
(годишни промени во %)



Извор: ММФ, Светска банка и пресметки на НБРСМ.

Vlerësimet për rritjen e **çmimeve të produkteve ushqimore** për vitin 2022 janë rishikuar në një drejtim tjetër krahasuar me prill. Kështu, për vitin 2022 pritet një rritje më e lartë e çmimit të misrit, që vjen si pasojë e pritjeve për uljen e prodhimit në Europë dhe SHBA, por rritje më të ulët të grurit, në masën më të madhe për shkak të perspektivës për rritjen më të lartë të prodhimit në disa vende më të mëdha (Kanadë, Kinë, Federata Ruse dhe ShBA) dhe rivendosjes së eksporteve nga Ukraina. Për vitin 2023, pritet një rënie për të dy produktet, por më pak se sa ishte parashikuar në prill.

Едномесечен Еурибор
(квартален просек, во %)




Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.


Нë EURIBOR-in njëmuјor, rishikimet janë në rritje për të gjithë periudhën e projeksionit, veçanërisht për vitin 2023, ku tani pritet të jetë mesatarisht rreth 0% në vitin 2022 (-0,47% në prill), ndërsa më 2023, niveli mesatar do të arrijë në 1,66 (0,27% në prill). Lëvizje të tilla janë në pajtim me normalizimin gradual të politikës monetare nga BQE-ja, ku pritet rritje e mëtejshme e normave të interesit gjatë tremuјorit të katërt të vitit.

Стапка на инфлација

(годишни придонеси во вкупната инфлација, во п.п.)



Придонеси кон годишната стапка на инфлацијата (во п.п.)



Në shtator të vitit 2022, **çmimet e konsumit vendas u rritën për 1,6% në bazë mujore** (1,3% në muajin paraardhës), kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve në komponentin ushqimor të inflacionit, me një kontribut minimal pozitiv nga komponentët energjetikë dhe bazë. Rritja e **çmimeve të ushqimeve** është kryesisht rezultat i rritjes së çmimeve në kategoritë “qumësht, djathë dhe vezë”, “bukë dhe produkte drithi” dhe mish, pavarësisht masave të marra për të zbutur trynitë e çmimeve në lidhje me kufizimin e marzheve tregtare në disa nga këto produkte, duke kufizuar eksportin e grurit dhe miellit dhe heqjen e taksës për importin e qumështit dhe ajkës⁵. Nga ana tjetër, çmimet e vajrave shënuan rënie edhe në shtator, me një rënie të vazhdueshme të çmimeve të aksioneve botërore për disa muaj rresht, në kushtet e importeve të mëtejshme pa taksa të vajit ushqimor të lulediellit⁶.


Çmimet e energjisë shënuan rritje mujore prej 1,3%, pas një rënie prej 2,7% në muajin paraardhës, si rezultat i rritjes së çmimeve të lëndëve djegëse të ngurta, në lidhje me të cilat u miratua një masë për kufizimin e eksportit të druve të zjarrit dhe peletit⁷. Rritja e çmimeve në komponentin e energjisë është zbutur nga rënia e mëtejshme e çmimeve të derivateve të naftës, ndonëse është më e dobët, në kushtet e një prirje të mëtejshme në rënie të çmimit të naftës bruto në bursat botërore.

⁵ Me Vendimin për kushtet e veçanta të tregtimit të mallrave të caktuara, të miratuar më 14 qershor 2022, Qeveria e RMV-së caktoi marzhin më të lartë tregtar të produkteve ushqimore bazë në tregtinë me shumicë dhe pakicë, i cili fillimisht ishte i vlefshëm deri më 30 shtator, e më pas u vendos që zbatimi i tij të vazhdojë deri në fund të vitit. Sipas vendimit, për bukën e bardhë (të prerë në copa ose të plota), për sheqerin e bardhë dhe për vajin e lulediellit ushqimor, me përjashtim të kullimit të ftohtë, përcaktohet marzhi tregtar me lartësi deri në 5% në tregtinë me shumicë dhe deri në 5% në tregtinë me pakicë, ndërsa për miell gruri (lloji 400 dhe 500), për makarona dhe shpageti nga gruri i fortë, oriz të bardhë maqedonas, qumësht të përhershëm të lopës me përmbajtje yndyre 2,8%, 3,2% dhe 3,5% dhe vezë pule, për të gjithë shoqëritë tregtare dhe tregtarët individualë që marrin pjesë në rrjetin tregtar, përcaktohet marzhi tregtar me lartësi deri në 10% në tregtinë me shumicë dhe deri në 10% në tregtinë me pakicë. Më 20 korrik, Qeveria mori vendim që të kufizojë deri në fund të vitit eksportin e grurit dhe gjysmatares dhe miellit të grurit dhe gjysmatares, për të parandaluar shqetësimet serioze në tregun e këtyre produkteve ushqimore bazë në vend. Gjithashtu më 30 gusht u vendos për të hequr normat doganore nga 20% dhe 15% për qumështin dhe ajkën (të pakoncentruar dhe pa sheqer të shtuar ose substanca të tjera ëmbëlsuese me një përmbajtje yndyre në masën që kalon 21%, por jo më shumë se 45% dhe të pakoncentruar dhe pa sheqer të shtuar me përmbajtje yndyre nga masë që kalon 10%, por nuk kalon 45% në ambalazh, përkatësisht masa neto e të cilit nuk i kalon 2,5 kilogramë), e vlefshme deri në fund të vitit.

⁶ Qeveria e RMV-së, më 20 korrik 2022, mori vendim për vazhdimin e zbatimit të masës për import pa doganë të vajit të lulediellit ushqimor deri në fund të vitit, e cila më parë ishte e vlefshme deri më 31 maj.

⁷ Qeveria e RMV-së, më 20 korrik 2022, mori vendim që të kufizojë eksportin e druve të zjarrit dhe peletit deri në fund të vitit, për të parandaluar dhe shmangur pasojat e shkaktuara nga kërkesa e shtuar e popullsisë për dru zjarri, të shkaktuara nga kriza globale energjetike.

Инфлација и цени на храната и енергијата (годишни промени, во %)



Извор: Државен завод за статистика и пресметки на НБРСМ.

Странски ефективни* и домашни цени на храна и безалкохолни пијалаци (индекси, 2015=100)



* Ефективните странски цени на храна се добиени како пондериран збир од цените на храната во земјите што се најзначајни трговски партнери на Северна Македонија во доменот на увозот на храна.

Извор: ДЗС, Еуростат и пресметки на НБРСМ.

Инфлациони базë në shtator ishte vetëm 0,2% në bazë mujore, që paraqet një ngadalësim të dukshëm krahasuar me rritjen mujore të gushtit (1,1%). Nga këndvështrimi strukturor, efekti i rritjes së çmimeve të shërbimeve të hotelarisë dhe produkteve dhe shërbimeve të higjienës personale kompensohet pothuajse plotësisht nga çmimet më të ulëta të udhëtimeve ajrore dhe aranzhimeve turistike (pjesërisht për shkak të efekteve sezonale).

Shkalla vjetore e inflacionit në shtator ishte 18,7% (16,8% në gusht), me rritje dyshifrore dhe të përshpejtuar të çmimeve në komponentët e ushqimeve dhe energjisë. Kontributin më të madh në shkallën vjetore të inflacionit e kanë rritja e çmimeve të ushqimeve, veçanërisht bukës dhe drithërave. Sa u përket karburanteve, rritja vjen nga rritja e çmimeve të energjisë elektrike për amvisëritë (në janar dhe korrik të këtij viti⁸), plotësuar nga rritja e çmimeve të derivateve të naftës dhe në një masë më të vogël nga çmimet më të larta të karburanteve të tjera. Shkalla vjetore e inflacionit të realizuar në shtator është mbi shkallën e projektuar nga cikli i projeksioneve të prillit, në kushtet e devijimeve kryesisht në rritjen e çmimeve të supozimeve hyrëse të jashtme, që tregon paparashikueshmëri të theksuar në raport me dinamikën e pritshme të çmimeve botërore të produkteve parësore. Prandaj, devijimi është më i theksuar në komponentin e energjisë dhe ushqimit.

Shkalla bazë e inflacionit në shtator është 8,8% me bazë vjetore (8% në muajin paraardhës), brenda së cilës kontributin më të lartë pozitiv e kanë çmimet e shërbimeve në restorante dhe hotele, të plotësuar nga çmimet e pijeve joalkoolike, të duhanit, produkteve të higjienës personale dhe të mirëmbajtjes rutinë të shtëpisë dhe çmimet e trafikut rrugor.

⁸ Sipas Vendimeve të Komisionit Rregullator të Energjetikës të RMV-së (KRRE), çmimi i energjisë elektrike për furnizuesin universal "EVN HOME" Sh.P.K Shkup është rritur për 9,48% në janar dhe mesatarisht 9,9% në korrik 2022 (tarifa e ulët prej 8,8%, kurse tarifa e lartë mesatarisht 10,4%). Nga 1 korriku, KRRE për herë të parë prezantoi çmimet e shkallëzuara për konsum në tarifën e lartë, përkatësisht prezantoi modelin me 4 bllok tarifa. Krahasuar me të vetmen tarifë të lartë të mëparshme, çmimi i energjisë elektrike për bllokun 1 është më i lartë për 5,5%, bllokun 2 për 10,3%, bllokun 3 për 18,3% dhe bllokun 4 për 138,7%. (<https://www.erc.org.mk/>).

Në lidhje me lëvizjet e pritshme të supozimeve hyrëse të jashtëm në projeksionin e inflacionit, rishikimet janë kryesisht në kahen në rritje, pra është bërë një rishikim në rritje i rritjes së inflacionit të huaj efektiv, çmimeve të naftës dhe misrit dhe një rishikim në rënie i rritjes së çmimit të grurit. **Duke marrë parasysh këto rishikime dhe efektet transferuese të rritjes më të fortë të çmimeve të importeve në inflacionin e realizuar deri më tani, rreziqet për shkallën e pritshme të inflacionit për këtë vit janë në rritje.** Në të njëjtën kohë, vazhdon të theksohet pasiguria e lartë në lëvizjen e çmimeve botërore të produkteve primare në periudhën e ardhshme, me efekte të pasigurta ekonomike të konfliktit aktual ushtarak në Ukrainë dhe sanksioneve ndaj Rusisë.

Në korrik të vitit 2022, rritja nominale vjetore e rrogës mesatare neto arriti në 11,5% (10,9% në muajin paraardhës). Rritja e rrogës minimale prej 18,5% në mars të vitit 2022, në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore vazhdon të kontribuojë kryesisht në rritjen vjetore të rrogave⁹. Njëkohësisht, rritje vjetore të rrogave në korrik ka në të gjitha aktivitetet, ndërsa rritja më e lartë, si në muajt e kaluar, është shënuar në aktivitetin e "hoteleve dhe restoranteve".

Me rritjen e shpenzimeve të jetesës me bazë vjetore, **rroga reale neto në korrik shënoi një rënie prej 3,9% me bazë vjetore** (nga 3,1% në muajin paraardhës).

Ndryshimi nominal dhe real vjetor i realizuar i rrogave në korrik të vitit 2022 (11,5%, përkatësisht -3,1%) korrespondon më së shumti dhe është në të njëjtin drejtim me normat që pritshmëritë e tremujorit të tretë në kuadër të

Просечна исплатена плата
(годишни стапки, во %)



Извор: ДЗС.

⁹ Në përputhje me ndryshimet dhe plotësimet e fundit ligjore për rritjen e rrogës minimale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 41/22) nga marsi 2022, është bërë rritje e jashtëzakonshme e rrogës minimale neto për 2806 denarë, në përputhje me marrëveshjen tripalëshe të arritur në mes të Qeverisë, sindikatave dhe punëdhënësve, ku shteti do të subvencionojë pjesën që ka të bëjë me kontributet (nga marsi 2022 deri në dhjetor 2022 në shumë prej 1197 denarë për çdo muaj). Lartësia e rrogës minimale në bruto, duke filluar nga marsi 2022 deri në shkurt 2023, është 26.422 denarë (më parë 22.146 denarë), përkatësisht rroga minimale në shumën neto është 18.000 denarë (më parë 15.194 denarë). Gjithashtu, me ndryshimet dhe plotësimet e fundit është përcaktuar metodologjia e re me të cilën do të harmonizohet rroga minimale në periudhën e ardhshme, pra nga marsi i vitit 2023, pra me rritjen për vitin e mëparshëm të rrogës mesatare të paguar në RMV dhe indeksi i shpenzimeve të jetesës - përkatësisht 50% e rritjes nga secili tregues. Po ashtu, përcaktohet se rroga minimale nuk mund të jetë më e ulët se 57% e lartësisë së rrogës mesatare neto të paguar në RMV për vitin e kaluar.


Просечна исплатена месечна нето-плата по сектори

(номинални годишни стапки, во %)



Извор: ДЗС.


Индикатор на економска доверба и БДП



Извор: ДЗС и Европска комисија.

Тë dhënat me frekuencë të lartë për anën e ofertës dhe kërkesës që disponohen për periudhën korrik - gusht 2022 tregojnë kryesisht për një ngadalësim të rritjes së aktivitetit ekonomik në tremujorin e tretë të vitit. Kur bëhet fjalë për perceptimet e subjekteve ekonomike për gjendjen e ekonomisë¹⁰, rezultatet e hulumtimit anketues për tremujorin e tretë të vitit tregojnë perceptime më pak të favorshme, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2021, si dhe perceptimet janë disi më pak të favorshme, krahasuar me tremujorin paraardhës. Perceptimet më pak të favorshme të subjekteve ekonomike mund të lidhen kryesisht me luftën në Ukrainë, me vazhdimin më të gjatë të niveleve të larta të inflacionit, si dhe me shtrëngimin e kushteve financiare.

Економски сектори
(реални годишни промени, во %)



* Прост просек од годишните стапки на промена на различните видови на транспорт и телекомуникациите.
Извор: ДЗС и пресметки на НБРСМ.


Në periudhën korrik - gusht 2022, **qarkullimi në tregtinë totale** shënoi një rritje të vogël reale vjetore, dukshëm më e ngadaltë krahasuar me rritjen e tremujorit paraardhës, me ngadalësim të rritjes së tregtisë me pakicë dhe rritje të vogël të tregtisë së automjeteve, e me rënie të lehtë në tregtinë me shumicë.

Në **shërbimet hotelerike** janë vërejtur shkallë solide të rritjes vjetore në numrin e përgjithshëm të turistëve, netëqëndrimeve dhe qarkullimit total në korrik, por dukshëm më ngadalë krahasuar me rritjen e tremujorit paraardhës.

Në periudhën korrik - gusht 2022, **prodhimi industrial** shënoi rënie reale vjetore prej 2,5%, kundrejt rritjes së vogël në tremujorin paraardhës. Rënia e industrisë është rezultat i

¹⁰ Ka të bëjë me sondazhet e kryera nga Komisioni European për të matur besimin ekonomik të subjekteve në një ekonomi. Treguesi i përbërë i besimit ekonomik është marrë si një mesatare e ponderuar e treguesve të besimit për konsumatorët dhe treguesve të besimit për sektorët e veçantë ekonomikë (ndërtimtari, industri, tregti me pakicë dhe shërbime).

Индикатори за угостителството
(реални годишни промени)



	2019				2020				2021				2022			
	Кв.1	Кв.2	Кв.3	Кв.4	Кв.1	Кв.2	Кв.3	Кв.4	Кв.1	Кв.2	Кв.3	Кв.4	Кв.1	Кв.2	мај	јул
реални годишни промени во %																
Бруто домашен производ	2.8	6.1	4.3	2.5	-1.3	-16.4	-5.9	-0.8	-1.8	13.4	3.0	2.3	2.4	2.8	-	-
Индустриско производство	8.8	1.1	7.1	-1.3	-3.7	-25.0	-7.5	-2.3	-6.1	22.3	-3.5	-2.3	3.4	1.3	8.5	-0.2
Извршени градежни работи	15.1	-3.3	3.0	5.3	6.3	-5.1	3.0	2.3	-1.1	-9.6	-10.8	-17.5	-11.1	-1.2	-7.3	4.3
Високоградба	-9.3	5.1	23.7	-1.1	-8.5	-20.4	17.9	-8.6	18.5	5.3	-20.2	-20.9	-26.0	15.2	-4.1	14.1
Нискоградба	58.3	-8.0	-6.7	11.1	21.3	4.7	-6.2	11.1	-16.1	-16.9	-3.5	-15.2	5.1	-11.3	-9.5	-2.2
Промет во трговијата - Вкупно*	13.9	12.8	15.3	15.5	-16.7	-30.6	-26.1	-24.3	0.9	22.5	16.9	10.4	9.7	4.0	1.9	3.0
Промет во трговијата на мало*	7.6	8.8	12.0	13.8	1.0	-18.6	-15.7	-15.5	-1.3	18.3	13.9	10.0	7.6	6.7	6.9	4.3
Промет во трговијата на големо*	18.0	16.0	18.1	17.3	-27.8	-40.1	-38.7	-36.3	3.7	27.9	28.4	19.6	11.0	2.4	-2.3	3.3

*Реалните стапки на раст се пресметани од НБРСМ, од деление на номиналните стапки на раст со показателот инфлација, мерена според трошоците на живот. Податоците за трговијата во 2020, 2021 и 2022 година се прелиминарни податоци, додека податоците за БДП во 2020 година се прелиминарни, а за БДП во 2021 и 2022 година се проценети.

Извор: ДЗС и пресметки на НБРСМ.

kontributit negativ të industrisë përpunuese dhe sektorit të energjisë, ndërsa xehetaria ka një kontribut të vogël pozitiv. Në kuadër të industrisë përpunuese, kontributi më i madh negativ vërehet në disa nga aktivitetet tradicionale, si prodhimi i metaleve dhe prodhimeve metalike të fabrikuar, si dhe prodhimi i produkteve ushqimore dhe prodhimi i produkteve të duhanit. Nga ana tjetër, kontributi më i madh pozitiv vërehet në disa nga aktivitetet në të cilat janë aktive kapacitetet më të mëdha të eksportit të huaj, si prodhimi i makinerive dhe i pajisjeve dhe prodhimi i pajisjeve elektrike, ndërsa në aktivitetet tradicionale kontributin më të lartë pozitiv e ka prodhimi i tekstilit.

Në korrik, **vlëra e punimeve të ndërtimit të kryera** në bazë vjetore shënoi një rënie dukshëm më të thellë krahasuar me rënien e tremujorit paraardhës, tërësisht si pasojë e rënies së lartë të ndërtimeve të ulëta, ndërkohë që ndërtimet e larta shënuan rritje.

